# AKT THEMELIMI I SHOQERISE " AKTIV LIFT ELEVATOR" SH.P.K.

**Znj. Ornela Qose,** lindur me 19.05.1984, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, me dokument identifikimi karte identiteti 028359357, shtetas Shqiptar, i cili shpreh deshiren sipas kerkesave te ligjit nr. **9901, date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" QKR** , per krijimin e shoqerise me te dhenat e meposhteme :

**NENI1**

Themeluesi me anen e ketij akti themelimi krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta emertoje **"AKTIV LIFT ELEVATOR" SH.P.K,** shoqeri e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e statutit qe i bashkalidhet ketij akt themelimi.

**NENI 2**

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane Rr. Dritan Hoxha, Blloku Gintash, Ndertesa 106, Hyrja 5, Ap. 5

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje periudhe **kohe te pakufizuar, mbi 10 vjet,** me te drejte perseritje per periudhen e metejshme, neqoftese ortaku i vetem bie dakort, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 3**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ne fushen e

- Import-export, montim dhe sherbime mirmbajtje ashensore. Shitje e ashensoreve dhe pjeseve te tyre.

**NENI 4**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 LEKE ( njeqind mije ) . Ky kapital eshte i ndare ne 1 kuote. Vlera nominale e cdo kuote eshte 100.000 LEKE ( njeqindmije). Ortaku i vetem Zoteron 100% te gjithe kapitalit te shoqerise.

**NENI 5**

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku. Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda tre muajve nga mbatimi i llogarive te percaktoje kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

**NENI 6**

Ortaku i vetem mund t'u shese te treteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte edhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

**NENI 7**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Ortaku i Vetem
- Administratori

**Afati i emerimit te administratorit eshte 5 vjet, me te drejte riperseritje , ne baze te nenit 95**

**te Ligjit 9901, dt.14.04.2009, sic eshte percaktuar ne statut.**
Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas statutit te shoqerise.

**NENI 8**

Ne mbledhjen e pare te shoqerise emerohet administrator i shoqerise **Znj. Ornela Qose,** lindur me 19.05.1984, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, me dokument identifikimi karte identiteti nr 028359357 , shtetas Shqiptar,.

**NENI 9**

Vendimet e ortakut te vetem mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim.

**NENI 10.**

Likujditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogaritet e saj rrjedhese. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i ortakut te vetem. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithe kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

**NENI 11**

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ortakut te vetem ne perpjestim me kontributin ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet, dhe te jene hequr 5 % qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

**NENI 12**

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

**NENI 13**

Ortaku i vetem eshte i detyruar te ruaje karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer, te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise .

**NENI 14**

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptin, do te paraqiten per zgjidhje ne gjykaten kompetente shqipetare, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

**NENI 15**

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakut te vetem duke shprehur ne te vullnetin e lire te tij. Akti i themelimit u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila, per t' u depozituar ne organet kompetente, tatimore, ne zyren e noterise, si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**
**"AKTIV LIFT ELEVATOR" SH.P.K,**

Ornela Qose
Ornela Qose

Dt: 06.02.2018.